TË DREJTA STUDIMI MASTER NË MALTË, VITI AKADEMIK 2017-2018

IMO International Maritime Law Institute në Maltë njofton për mundësinë e ndjekjes së programeve të studimit **Master në Drejtësi (LL.M)**, në drejtimet e mëposhtme:

- E drejtë ndërkombëtare Detare;
- Master në Shkencat Humane (M.Hum);
- Legjislacion Ndërkombëtar Detar.

Këto studime do të fillojnë në tetor 2017 dhe do të zgjasin 1 vit akademik.

Për të gjitha degët e studimit, studimet do të zhvillohen në **gjuhën angleze**.

Kandidatët, do të përzgjidhen në bazë të kritereve si vijon:

- Zotërimi i një diplome në drejtësi me rezultate të larta dhe nga një universitet i njohur;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e gjuhës angleze (për këtë kandidatëve mund t'u kërkohet vërtetimi i tyre nga teste ndërkombëtare si IELTS, Cambrige, TOEFL, etj).

Aplikantët e interesuar, duhet të dorëzojnë një formë aplikimi të shoqëruar nga dokumentacioni plotësues që përfshin diplomën e Universitetit, çertifikatën e gjuhës angleze të mbrojtur, raport mjekësor të certifikuar, një letër interesi, dy letra reference si dhe një shumë të pakthyeshme prej 150 € që shërben për shqyrtimin e aplikimit.
Ky dokumentacion do të përcillet me postë në adresën zyrtare të IMO International Maritime Law Institute:
The Director; IMO International Maritime Law Institute; Msida Heights, Tal- Qroqq P.O.Box 31; Msida MSD 1000; MALTA.

Për një informacion më të detajuar për programet e studimit, mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë që gjenden në adresën web: *www.imli.org*.

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE